



# ALB-AUDIT

ALB-AUDIT sh.p.k  
Rr. EMIN DURAKU  
Nd.2, H. 6, Ap. 10  
Njesia Bashkiake Nr.5, Kodi Postar 1019  
TIRANE  
NIPT : L 01417011 K  
Tel/fax +35542251744 , Cel . 0692042251  
Email.albaudit@gmail.com :hsulai@vaho.com

## RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAU

Drejtuar : KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

Adresa : Pallati i Kongreseve , Tirane Shqiperi

Ne kemi audituar pasqyren (deklaraten) bashkalidhur te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore, per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore date 21 Qershor 2015 te Partise Konservatore , e cila ka marre pjese ne zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21 .06.2015, si force politike.

### **Pasqyra është përgjegjësi e drejtimit të subjektit zgjedhor Partia Konservatore.**

Kjo pasqyrë (deklarata) është përgatitur nga kandidati bazuar ne librin e llogarive dhe të rregjistrit të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjithë transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore, që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës së arkëtim-pagesave. (deklaratës) .

### **Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin e kryer.**

Ne kemi kryer auditimin ne perputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit në referencë të vecantë me SNA 800 “Konsiderata të vecanta-Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike” . Këto standarte kërkojnë që ne të veprojmë në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyra financiare e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të mos përmbajë anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi në lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrën bashkëlidhur. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit dhe përfshijnë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrës përkatëse, qoftë për shkak të mashtrimit, ashtu dhe të gabimit. Për vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm të kandidatit që ka të bëjë me përgatitjen e pasqyrës me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të saj. Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrën financiare, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura të vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga kandidati, si dhe një vlerësim të paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Ne çmojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

### **Ceshtje ne Vemendjen Tuaj**

**Ne kerkojme vemendjen tuaj ne lidhje me ,**

Detyra e subjektit zgjedhor , **Partia Konservatore**, është të përgatisë pasqyrën financiare mbi bazën e arkëtimit dhe pagesave. (subjekti deklaron se nuk ka perfituar asnje fond publik dhe jopublik dhe nuk ka bere shpenzime).

### **Opinion**

Sipas mendimit tonë, duke marrë në konsiderat *Ceshtje ne Vemendjen Tuaj*, pasqyra (deklarata) e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore në organet e qeverisjes vendore date 21 Qershor 2015 e **Partise Konservatore** , është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kerkesat e raportimit mbi bazën e arkëtimit dhe të pagesave , konform me ligjin nr 9228 datë 29/04/2004 “ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare’.

Tirane , me 25 Tetor 2015

**ALB-AUDIT sh.p.k**

**Hetem SULAJ**

**EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR**